



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.05.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË FUTSALIT
- FC "PRISHTINA FUTSAL 01"

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futsalit - FC "PRISHTINA FUTSAL 01" .

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 20,000.00 € (njëzet mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Sportit.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, klubit të futsalit - FC "PRISHTINA FUTSAL 01", të cilën Komuna e Prishtinës e ndanë si mbështetje financiare për pjesëmarrje në garat vendore dhe ndërkombëtare, siç është Champions League.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-107130/23, më 29.05.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

